

URDHËR
Nr. 218, datë 4.6.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 169, DATË 5.6.2020, “PËR ZBATIMIN E PROTOKOLLEVE TË OPERIMIT NË TRANSPORTIN AJROR, TRANSPORTIN RRUGOR DHE TRANSPORTIN DETAR, NË KUADËR TË PARANDALIMIT DHE KONTROLLIT TË PANDEMISË COVID-19”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar; dhe në përputhje me ligjin nr. 96/2020, datë 15.7.2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”; me ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; me ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pika 1 e urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 169, datë 5.6.2020, “Për zbatimin e protokolleve të operimit në transportin ajror, transportin rrugor dhe transportin detar, në kuadër të parandalimit dhe të kontrollit të pandemisë COVID-19”, ndryshohet si më poshtë:

“1. Protokollat e operimit në transportin ajror, transportin rrugor dhe transportin detar, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të parandalimit dhe të kontrollit të pandemisë COVID-19, janë sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe autoritetet portuale për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

PROTOKOLLET E OPERIMIT

**NË TRANSPORTIN AJROR, TRANSPORTIN RRUGOR DHE TRANSPORTIN DETAR,
NË KUADËR TË PARANDALIMIT DHE KONTROLLIT TË PANDEMISË COVID-19**

Protokollet e operimit në transportin ajror, transportin rrugor dhe transportin detar mundësojnë vendosjen e masave proporcionale dhe efektive, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit të personelit dhe të pasagjerëve, duke zvogëluar rrezikun e transmetimit SARSCoV-2 sa më shumë që të jetë e mundur.

A. MENAXHIMI I OPERIMEVE NË TRANSPORTIN AJROR

i. Autoriteti i Aviacionit Civil do të mbikëqyrë zbatimin e këtij protokollit nga Enti Menaxhues i Aeroportit dhe operatorët ajrorë që fluturojnë për dhe nga Shqipëria, si dhe do të koordinojë me Institutin e Shëndetit Publik dhe Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor për të lehtësuar zbatimin.

ii. Enti Menaxhues i Aeroportit dhe operatorët ajrorë do të marrin masa për zbatimin e parashikimeve të këtij protokollit dhe do të koordinojnë me Autoritetin e Aviacionit Civil, si Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës, për masat në fjalë, me qëllim të arritjes së një mitigimi optimal të riskut. Enti Menaxhues i Aeroportit dhe operatorët ajrorë do të monitorojnë efektivitetin e masave

të marra dhe do të mbledhin të dhëna të cilat do t'ia transmetojnë Autoritetit të Aviacionit Civil mbi baza javore.

iii. Materiale promovuese të sigurisë së shëndetit duhet të jenë gjerësisht të disponueshme në aeroport (hyrje, ekranet informuese, portat etj.). Materialet duhet të jenë të disponueshme në anglisht dhe në shqip. Këto materiale duhet të jenë të disponueshme edhe në kabinën e fluturimit, mundësisht me audio dhe video dhe kur nuk është e mundur me fletëpalosje në xhepat e ndenjësve të avionit. (Aneksi 2 i këtij protokoll.)

iv. Enti Menaxhues i Aeroportit, në përputhje me planin e tij të emergjencave, duhet të caktojë një koordinator për të garantuar zbatim të masave parandaluese në mënyrë uniforme nga të gjitha subjektet që ofrojnë shërbime në aeroport.

1. MENAXHIMI I PASAGJERËVE NË ÇDO KOHË

1. Pasagjerët duhet të mbajnë distancën prej 1 metër në aeroport. Enti Menaxhues i Aeroportit dhe operatorët ajrorë duhet të marrin masa për paralajmërimin e pasagjerëve për këtë rregull dhe vendosjen ku është e mundur të shenjave dalluese të distancimit fizik.

2. Pasagjerët dhe personat brenda aeroportit dhe avionëve duhet të mbajnë maska mjekësore të thjeshta, nga momenti që hyjnë në terminal në zonën e nisjeve deri sa dalin nga ndërtesa e terminalit, në aeroportin e destinacionit të tyre. Përrjashtëm nga kjo rregull mund të bëhet kur nevojitet gjatë kontrollit të sigurisë në aviacion dhe atij të kufirit; për fëmijët nën 6 vjeç dhe personat që kanë arsye shëndetësore të dokumentuara.

3. Maskat duhet të ndërrohen çdo 4 orë, nëse nuk këshillohet ndryshe nga prodhuesi, gjithashtu, edhe kur lagen apo dëmtohen. Qese me një përdorim për hedhjen e maskave të përdorura duhet të jenë disponibël në bord të avionit dhe gjatë zbritjes.

4. Enti Menaxhues i Aeroportit nuk duhet të vendosë në aeroport kosha mbetjesh me prekje.

5. Procedura për përdorimin e maskave, heqjen e tyre dhe nxjerrjen jashtë përdorimit në mënyrën e duhur të maskave të përdorura duhet të paraqitet nga ana e Entit Menaxhues të Aeroportit dhe operatorit ajror në materialet promovuese të sigurisë së shëndetit.

5.1 Përdorimi i maskave të fytyrës është një masë plotësuese, ndërkohë që do të vijojnë të zbatohen masat parandaluese të distancimit social, etikës respiratore, prekjës së fytyrës dhe higjienës së duarve.

6. Enti Menaxhues i Aeroportit, operatorët ajrorë dhe ofruesit e shërbimeve duhet të ofrojnë setin standard në këtë rast të Mjeteve të Mbrojtjes Personale (MMP), për anëtarët e stafeve të tyre dhe të trajnojnë stafin për përdorimin përkatës.

7. Stafit që vepron me pasagjerët drejtpërdrejt duhet të veshë maskën mjekësore të thjeshtë ose prej cope, doreza dhe uniformë; uniformat duhet të ndërrohen çdo ditë dhe kur nuk mund të ndërrohen çdo ditë, do të përdoren kostume mbrojtës. Agjentët e sigurisë që bëjnë kontroll fizik duhet të vendosin mbrojtëse xhami (*plexiglas*) në fytyrë krahas maskave.

8. Stafit që ndërvepron me pasagjerët në sportel, nëpërmjet një mbrojtësi të fortë ndarës (*plexiglas*) nuk është i detyruar të veshë MMP gjatë gjithë kohës. Këto struktura ndarëse duhet të kenë hapësirën e nevojshme të hapur për dorëzim të dokumenteve dhe pasagjerët, përveçse kur dorëzojnë dokumentet ose bagazhin, duhet të mbajnë distancë nga sporteli. Kjo duhet të udhëzohet nga Enti Menaxhues i Aeroportit me shënime specifike në dysheme, të cilat do të zgjaten në të gjithë radhën, për të mundësuar mbajtjen e distancës fizike (prej 1 m).

9. Pasagjerët do të udhëzohen rregullisht për zbatimin e masave parandaluese nëpërmjet mesazheve vizuale dhe audio, si dhe me mjete të tjera, në aeroport dhe në bord të avionit. Pasagjerët duhet të udhëzohen nga Enti Menaxhues i Aeroportit dhe operatorët ajrorë edhe për pasojat e moszbatimit të masave parandaluese.

9.1 Pasagjerët që nuk zbatojnë masat parandaluese:

a) Nuk do t'u jepet akses në ndërtesën e terminalit të aeroportit, në kabinë ose do të zbriten nga avioni, në rastet kur ngjarja ndodh përpara se të mbyllen dyert e avionit dhe do të largohen nga aeroporti nga autoritetet e rendit publik. Refuzimi nga ana e pasagjerit para nisjes së fluturimit, për të zbatuar masat mbrojtëse parandaluese në fuqi do të konsiderohet rast i justifikuar për moslejimin e vazhdimit të fluturimit për pasagjerin që me gjithë paralajmërimet e përsëritura nuk pranon t'i zbatojë ato.

b) Koordinatori i caktuar nga Enti Menaxhues i Aeroportit sipas këtij protokollit, sapo të sinjalizohet për një rast të moszbatimit të masave parandaluese do të njoftojë autoritetet kompetente për rendin publik në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

c) Nëse ngjarja ndodh gjatë fluturimit, do të zbatohen procedurat e trajtimit të pasagjerëve të parregullt dhe masa të mëtejshme për vënien në rrezik të sigurisë së operimit dhe të sigurisë së shëndetit të pasagjerëve të tjerë dhe të anëtarëve të ekuipazhit mund të ndërmerren nga autoritetet lokale në aeroportin e destinacionit, sipas kërkesave kombëtare përkatëse.

PËRPARA MBËRRITJES NË AEROPORT

1. Pasagjerët që shfaqin simptoma të COVID-19 nuk do të lejohen të udhëtojnë nëpërmjet ajrit.

2. Operatorët ajrorë, në bashkëpunim me Entin Menaxhues të Aeroportit, duhet të informojnë pasagjerët e ardhshëm nëpërmjet masave promovuese, për kufizimin e udhëtimit për pasagjerët që mund të kenë simptomat e COVID-19 përpara mbërritjes në aeroportin e tyre të nisjes. Masat promovuese duhet të përfshijnë edhe simptomat për t'u konsideruar.

3. Pasagjerët në aeroport, që identifikohen simptomatikë nga autoritetet e shëndetit publik mund të mos lejohen të vazhdojnë udhëtimin. Operatorët duhet të kujtojnë herë pas here pasagjerët mbi këtë rregull.

4. Operatorët ajrorë dhe të aeroportit duhet të informojnë pasagjerët për detyrimin për veshjen e maskës mbrojtëse në aeroport dhe në avion, përveçse kur specifikohet ndryshe në rast të kontrolleve të sigurisë dhe kufirit. Gjithashtu, ata duhet të informojnë pasagjerët për kohëzgjatjen e pritshme të realizimit të masave parandaluese, për një llogaritje të mbërritjes së tyre në aeroport në kohë. Koha që pasagjerët duhet të kalojnë në aeroport duhet të jetë sa më e shkurtër.

5. Përpara mbërritjes në aeroport, jo më afër se 24 orë përpara fluturimit, pasagjerët duhet të njihen me informacionin mbi simptomat e COVID-19 dhe risqet e kontakteve të mundshme me rastet e COVID-19 dhe duhet të firmosin (njihet edhe pranimi në mënyrë elektronike) njohjen e këtij informacioni, sipas deklaratës bashkëlidhur këtij protokollit (aneksi 1).

6. Operatorët e avionit duhet të bëjnë një deklaratë të ngjashme për ekuipazhin nën programin e tyre monitorues. Në rast dyshimi për simptoma apo çështje të lidhura me shëndetin, anëtari i ekuipazhit do të lëvizet menjëherë nga detyrat e fluturimit, pa shkaktuar presion apo frikë për masa ndëshkuese.

MENAXHIMI I PASAGJERËVE NË AEROPORTIN E NISJES

PASTRIMI DHE DEZINFEKTIMI

1. Për të zvogëluar rrezikun e rënies në kontakt të pasagjerëve dhe punonjësve me virusin COVID-19 gjatë qëndrimit në aeroport, aeroporti duhet të sigurojë, higjienizimin dhe pastrimin, disa herë në ditë, të zonave të brendshme të aeroportit me vëmendje veçanërisht në pikat ku përqendrimi i pasagjerëve është më i madh, siç janë p.sh.: sportelet e *check in*-it, kontrollet e sigurisë, portat e imbarkimit, sallat e kthimit të bagazheve, tualetet, duke përfshirë sistemet e kondicionimit, filtrat e ajrit, për të cilët duhet të rritet frekuenca e ndërrimit. Duhet të sigurohet, gjithashtu, edhe higjienizimi dhe pastrimi i zonave të jashtme tokësore, me referencë të veçantë për "kthesat/oborrin/sheshin e jashtëm" në pjesën e përparme të terminalit.

2. Higjienizimi dhe pastrimi duhet të bëhen duke përdorur personelin e caktuar dhe të trajnuar, dhe produkte të përshtatshme, bazuar në udhëzimet e dhëna nga autoritetet shëndetësore për të garantuar efektivitetin e ndërhyrjeve dhe duke marrë parasysh nevojën për të mos dëmtuar sipërfaqet ose sistemet e aeroportit dhe mjedisin.

3. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të caktojë procedura për të garantuar që pastrimi dhe dezinfektimi kryhet në mënyrë të vazhdueshme.

4. Nënkontraktorët dhe përdoruesit e hapësirave dhe të zyrave duhet të garantojnë, duke e vërtetuar që aplikojnë masat për higjienizimin dhe pastrimin e hapësirave dhe sipërfaqeve, sipas mënyrave të njëjta të përshkruara më sipër.

5. Për një menaxhim efektiv të rrezikut të infektimit, ndërhyrjet e higjienizimit rekomandohen në të gjitha zonat e terminalit (p.sh. zyrat, hapësirat operative, hapësirat tregtare) dhe automjetet e aeroportit të përdorura nga operatorët dhe pasagjerët.

6. Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe eliminimit të shpejtë të grimcave më të lehta, të çliruara në ajër nga njerëzit, dhe që bien në tokë me shpejtësi më të reduktuar, Enti Menaxhues i Aeroportit, përpara rihapjes dhe gjatë funksionimit, duhet të bëjë kontrollet e duhura të sistemeve të ajrosjes: verifikimin e prurjeve të ajrit, ndërrimin e ajrit sipas numrit të njerëzve, matjen e cilësisë së ajrit. Më pas duhet të parashikohet, sa më shpejt që të jetë e mundur, verifikimi i përmirësimeve të mundshme të efikasitetit të impianteve, me instalimin e sistemeve të përhershme të matjes së cilësisë të ajrit, rritjen e shkëmbimeve të reja të ajrit, përmirësimin/fuqizimin dhe kalibrimin për rritjen e prurjeve të ajrit dhe krijimin e rrugëve të pastra të kalimit të ajrit në funksion të përdorimit të hapësirave, përmirësimin dhe/ose instalimin e pajisje të reja të sistemeve *hardware* dhe *software* për menaxhimin e ajrit. Këto ndërhyrje duhet të koordinohen me çdo rregullim të mundshëm funksional të hapësirave dhe të rrugëve të kalimit të destinuara për pasagjerët dhe ekuipazhet, për të luftuar përhapjen e virusit COVID-19.

7. Sistemi i ngrohjes, ajrosjes dhe kondicionimit të ajrit duhet të optimizohet për të garantuar nivel të lartë të ndërrimit të ajrit.

8. Operatorët ajrorë duhet të kryejnë pastrimin dhe dezinfektimin e avionit, sipas udhëzuesve për dezinfektimin dhe pastrimin, në fuqi.

9. Operatorët ajrorë duhet të përdorin lëndë të përshtatshme për përdorim në aviacion, pas çdo fluturimi që vjen nga një aeroport i vendosur në një zonë me rrezik të lartë të transmetimit të infeksionit COVID-19.

Të tilla janë ato substanca që përmbajnë alkool etanol 62%–71%, peroksid hidrogjeni 0,5% ose 0,1% hipoklorit i natriumit. Përshtatshmëria e ledeve duhet të kontrollohet sipas dokumenteve të prodhuesit të avionit.

10. Operatori ajror duhet të sigurojë në avion një ose më shumë Komplete Parandaluese Universale (KPU). Këto komplete duhet të përdoren për të mbrojtur anëtarët e ekuipazhit të cilët janë duke ndihmuar raste të dyshuara të COVID-19 dhe në pastrimin dhe heqjen e duhur të çdo përmbajtjeje potencialisht infektive.

11. Ekuipazhi i pastrimit duhet:

1.1 Të përdorë mjete të ndryshme pastrimi në zona të ndryshme, duke përdorur mundësisht kodimin me ngjyrë, në mënyrë që të zvogëlohet kontaminimi ndërmjet zonave;

1.2 Të shmangë dëmtimin e pjesëve dhe të përbërësve të avionit me dezinfektuesit;

1.3 Të spërkasë dyshemenë në drejtim nga fillimi në fund, përpara dezinfektimit dhe më pas të spërkasë përsëri në drejtim të kundërt;

1.4 Të dezinfektojë zonat kryesore, siç është specifikuar më poshtë, duke filluar nga lartë poshtë, duke punuar në mënyrë progresive nga zona të pastra në ato të ndotura:

1.4.1 **Korridor:** Tavanet, koshat e sipërm, dritat e leximit, daljet e ajrit, panelet anësore, dritaret, vendet (tavolinat e tabakatë, armaturat, njësitë e kontrollit të pasagjerëve dhe panelet dekorative), dollapët/dollapët me kyç, raftet e revistave, kabinën, ulëset e stjuardesave.

1.4.2 **Tualet:** Dezinfektimi në tualet duhet të fillojë nga zona të ndotura drejt atyre të pastra, si më poshtë: tualeti, koshat e mbeturinave, lavamani, muret e lavamanit, tavani, dyert (sipërfaqet, dorezat e dyerve, çelësi i derës etj.).

1.4.3 **Kuzhina:** Tavani, furrat, kaldaja me ujë, prodhuesit e kafesë, ambientet, dollapët/dollapët me kyç, koshat e mbeturinave.

1.4.4 **Kabina e pilotit:**

1.4.5 Për avionët ku kabina e pilotit është e ndarë nga kabina e pasagjerit, dezinfektimi parandalues duhet të konsiderohet vetëm kur ekuipazhi i fluturimit ka pasur një ndalesë më të gjatë duke rezultuar në ekuipazh që del jashtë zonës së kufizuar të aeroportit (p.sh. udhëtimi në hotel për një periudhë pushimi) në zonat me rrezik të lartë. Përndryshe kabina duhet t'i nënshtrohet pastrimit rutinë.

1.4.6 Për avionët ku ndarja e fortë midis kabinës së pilotit dhe kabinës së pasagjerëve nuk është e disponueshme frekuenca e dezinfektimit parandalues të kabinës së pilotit duhet të jetë e njëjtë me zonën e pasagjerëve.

2. AKSESI NË AEROPORT

1. Vajtje-ardhja në aeroport kryhet vetëm me automjet ose me taksì dhe sipas rregullave të përcaktuara për numrin e personave të lejuar në një automjet, përjashtuar rastet kur personat janë nga një familje, fëmijët e mitur dhe personat me aftësi të kufizuara.

2. Vajtje-ardhja e stafit të punësuar apo persona të tjerë si staf i shoqërive ajrore, punëtorë, staf i zyrave të tjera etj. kryhet me automjet, me taksì si dhe me autobus/mikrobus/furgon, i cili dezinfektohet dhe lahet përditë. Ulja në këto mjete kryhet duke lënë një hapësirë bosh në radhë dhe vetëm me një person në secilin rresht. Autobuzat dezinfektohen/lahen përditë sidomos ndenjësjet dhe sipërfaqet e prekura (Ky proces evidentohet sipas rregullave të brendshme të entit që i disponon dhe sipas rekomandimeve të mundshme nga DPSHTRR-ja dhe ISHP-ja).

3. Të gjithë personat pasagjerë, shoqërues apo staf i punësuar detyrimisht mbajnë maskën veshur në rrugën vajtje-ardhje për në apo nga aeroporti.

3. DEKLARATA E COVID-19

Në përputhje me rregullat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, pasagjerët duhet të plotësojnë një deklaratë mbi statusin e tyre të COVID-19 përpara se të kenë një leje për të hipur në bord të avionit (*boarding pass*), gjatë procesit të *check in*. (Deklarata në shtojcën 1 të këtij protokoll.)

4. HYRJA NË GODINËN E AEROPORTIT DHE LËVIZJA E PASAGJERIT NË NISJE

1. Pas hyrjes në aeroport nga secila hyrje, Enti Menaxhues i Aeroportit vë në dispozicion higjienizues për duart me produktin përkatës me përmbajtje mbi 70% alkool.

2. Enti Menaxhues i Aeroportit merr masa që në aeroport të krijohet mundësia e blerjes së maskave në rast se pasagjerët nuk kanë maska personale.

3. Operatorët ajrorë në koordinim me entin menaxhues të aeroportit, duhet të marrin masa që kontakti pasagjer-staf të kryhet përmes xhamit mbrojtës (*plexiglass*). Gjithashtu, vendosen shenjat e pritjes në radhë në distancë prej 1 metrash, si dhe distancë nga banaku prej 1 metër. Inkurajohet kryerja e *check in online* për të shmangur radhët dhe kontaktet fizike.

4. Pasagjerët duhet të inkurajohen nga operatorët ajrorë për të minimizuar bagazhin e dorës dhe kalimin e bagazheve në kompartmentin e kargos. Nuk lejohet mbajtja e baterive lithium në pajisje ose më vete në bagazhet e kontrolluara.

5. Në kontrollin e sigurisë, pasagjerët, presin në radhë duke respektuar distancën prej 1 metrash. Për këtë arsye vendosen shenjat përkatëse (shirita me ngjyrë të dallueshme) të pritjes në radhë.

Personeli i sigurisë përdor maskë dhe mbrojtëse me xham mbrojtës (*plexiglass*). Pas çdo kontrolli me prekje të objekteve kryhet higjienizimi i duarve. Gjatë kontrolleve të sigurisë, sugjerohet minimizimi i rasteve të kontrollit me duar (*hand search*), pa neglizhuar kërkesat e sigurisë së aviacionit. Në zonën e kontrollit vendoset detyrimisht produkti higjienizues i duarve.

6. Pas kalimit të kontrollit të sigurisë, duke ruajtur distancën prej 1 metra pasagjeri i drejtohet kontrollit të pasaportës. Kabina e kontrollit pajiset me ndarëse të fortë mbrojtëse. Pasaporta, bileta, prokura për fëmijët, apo çdo dokument tjetër, shqyrtohen duke u vendosur fizikisht në xhamin mbrojtës përmes së cilit lexohet nga punonjësi i policisë, duke shmangur pra sa më shumë prekjen e dokumenteve. Pas kryerjes së kontrollit pasagjeri dezinfekton duart me higjienizues në dalje nga kjo zonë. Higjienizuesi vendoset menjëherë pas daljes.

7. Në pritje në dalje (*gate*) për t'u nisur, duhet të shmangen grumbullimet e personave. Pritja duhet realizuar duke ruajtur distancën e sigurisë. Në stola lihet një vend bosh i lirë për të respektuar distancën. Imbarkimi në avion duhet të kryhet në këmbë dhe jo me autobus. Enti përfaqësues i aeroportit merr masa për krijimin e korsive të dedikuara të ecjes në këmbë dhe pritjes jashtë avionit për futjen me radhë të pasagjerëve duke garantuar distancën prej 1 metrash. Prioritet kanë personat e moshuar, personat në nevojë dhe familjet me fëmijë të mitur. Këta duhen sistemuar nga kompania ajrore në fillim të avionit. Ky sistemim kryhet përmes caktimit të vendeve prioritare në *check in*.

8. Nëse nevoja kërkon imbarkimin nëpërmjet autobusit, duhet të rritet numri i autobusëve për të siguruar distancën nevojshme fizike.

5. MENAXHIMI I PASAGJERËVE NË BORD TË AVIONIT

1. Staf i punësuar mban në çdo moment maskat dhe dorezat veshur që nga ardhja në aeroport dhe deri në mbërritjen në aeroportin tjetër ku zbatojnë masat e protokollit sipas secilit destinacion.

2. Pasagjeri, do të informohet nga ekuipazhi i operatorit ajror, me materiale udhëzuese, në lidhje me zbatimin e masave parandaluese në bord të avionit që përfshijnë:

2.1 Higjienizimi i duarve, veçanërisht para ngrënës apo pirjes, dhe para përdorimit të tualetit;

2.2 Përdorimi i maskës;

2.3 Etika respiratore;

2.4 Kufizimi i kontakteve me sipërfaqet e kabinës së avionit;

2.5 Kufizim i kërkesave për shërbime në bord.

3. Në informimet që i jepen pasagjerit, duhet të përfshihet instruksioni për heqjen e maskave të ftyrës në rast të emergjencave dhe përpara përdorimit të maskës së oksigjenit. Po kështu edhe ekuipazhi informohet nga operatori i avionit që duhet të heqë maskën mbrojtëse, kur jep instruksione në rast emergjence.

4. Pavarësisht detyrimit të pasagjerit për të mbajtur maskë, operatori ajror duhet të garantojë furnizim të mjaftueshëm me maska në avion, veçanërisht për fluturime të gjata.

5. Nuk rekomandohet shërbimi i ushqimit apo lëngjeve në bord. Në rast se do të shërbehen, mbetjet e tyre duhet të mblidhen sa më shpejt dhe të vendosen në vend grumbullim të veçantë. Staf shërben vetëm me doreza dhe maskë mbrojtëse.

6. Pasagjeri duhet të informohet lidhur me masat e aeroportit të shtetit ku do të mbërrijë. Ky informim kryhet në momentin e blerjes së biletës ose në bordin e avionit nëpërmjet audios, videos apo fletëpalosjeve të ilustruara me foto apo infografike të kuptueshme. Ndryshimet e momenteve të fundit duhet të komunikohen me mjetet e përshtatshme më parë në mënyrë që pasagjerët të marrin masat përkatëse.

7. Nuk do të lejohet *duty free* apo shitje të tjera në bord të avionit.

8. Tualetet e avionit duhet të dezinfektohen përpara çdo fluturimi. Përdorimi i shpeshtë i tyre duhet të reduktohet.

9. Operatorët ajrorë që përdorin riqarkullim të ajrit të kabinës ose do të instalojnë dhe përdorin filtrat HEPA (filtrat me eficiencë të lartë të ajrit të grimtuar), sipas specifikave të prodhuesit ose do të shmangin përdorimin e riqarkullimit të ajrit të kabinës tërësisht, me kusht që të konfirmohet se kjo nuk do të rrezikojë asnjë nga funksionet kritike të sigurisë në operim (p.sh. ftohja avionike, presioni i kabinës etj.). Kur instalohen filtrat HEPA, ventilatorët e riqarkullimit nuk duhet të ndalen, por rritja e rrjedhës së ajrit të freskët duhet të përdoret, duke zgjedhur paketën e lartë të nxjerrjes së ajrit, kurdo është e mundur.

10. Operatorët ajrorë duhet të rishikojnë procedurat e tyre për përdorimin e ventilatorëve të riqarkullimit të ajrit dhe sistemeve të kondicionimit, bazuar në informacionin e dhënë nga prodhuesi i avionit. Operatorët duhet të konfirmojnë praktikën e zgjedhjes së konfigurimit të paketave të rrjedhjes së lartë të ajrit, me prodhuesit e avionëve dhe të ndjekin ato udhëzime për përdorim të vazhdueshëm.

11. Operatorët ajrore, në kuadër të zbatimit të masave parandaluese të distancimit social, përveç masave të tjera shëndetësore dhe higjienike që duhet të respektohen në çdo kohë, kur lejohen nga ngarkesa e pasagjerëve, konfigurimi i kabinës dhe kërkesat për masën dhe ekuilibrin, duhet të sigurojnë, sa të jetë e mundur, distancën fizike midis pasagjerëve. Anëtarët e familjes dhe individët që udhetojnë së bashku si pjesë e së njëjtës familje mund të ulen pranë njëri-tjetrit. Procesi i ndarjes së vendeve duhet të modifikohet në përputhje me rrethanat.

12. Operatorët ajrorë dhe enti menaxhues i aeroportit duhet të marrin masa që pasagjerët të mos qëndrojnë në bord të avionit më gjatë se 30 minuta pa ventilimin e duhur.

13. Dalja nga avioni kryhet me radhë duke respektuar distancën.

6. MENAXHIMI I PASAGJERËVE ME SIMPTOMA NË BORD TË AVIONIT

Në rast se, pas ngritjes së avionit, një pasagjer dëshmon simptoma që përputhen me COVID-19, siç janë: temperatura, kolla, të vjella, diarre, vështirësi në frymëmarrje apo simptoma të tjera gripi, ndaj tij do të merren masat e mëposhtme:

1. Ekuipazhi siguron që pasagjeri simptomatik ka vendosur siç duhet maskën dhe vë në dispozicion maska të tjera. Nëse pasagjeri ka vështirësi në frymëmarrje, duhet t'i ofrohet asistencë mjekësore dhe furnizim me oksigjen të shtuar:

1.1 Pasagjeri duhet të izolohet në bord. Në varësi të konfigurimit të avionit dhe disponueshmërisë së rastit, pozicionin e rastit simptomatik dhe për aq sa është e mundur duhet të caktohet një zonë izolimi, duke lënë për aq sa është e mundur 2 radhë me ndenjës të lira, rreth çdo drejtimi të pasagjerit të dyshuar;

1.2 Aty ku është e mundur tualeti më pranë pasagjerit të dyshimtë duhet të dedikohet specifikisht për të dhe nuk duhet të përdoret nga pasagjerët e tjerë dhe ekuipazhi;

1.3 Sipas përbërjes së ekuipazhit të kabinës, anëtari më i lartë i ekuipazhit të kabinës përcakton anëtarë të caktuar të ekuipazhit për të ofruar shërbime në fluturim në zonën e izoluar. Këta anëtarë duhet të jenë ata që kishin kontakt me pasagjerin e dyshuar dhe duhet të përdorin MMP nga Kompleti Parandaluese Universal i avionit. Ekuipazhi i dedikuar duhet të minimizojë kontaktin me pjesën tjetër të ekuipazhit dhe pasagjerët e tjerë.

2. Aty ku është e mundur, valvula individuale e ajrit për pasagjerin simptomatik duhet të mbyllet;

3. Nëse pasagjeri i dyshuar udhëton i shoqëruar, shoqëruesi duhet të vendoset në zonën e izoluar edhe pse nuk shfaq simptoma;

4. Ekuipazhi duhet të njoftojë aeroportin e destinacionit, nëpërmjet sistemit të kontrollit të trafikut ajror, të ndjekë udhëzimet e tyre dhe të plotësojë pjesën shëndetësore të deklaratës së përgjithshme të avionit për të regjistruar informacionin shëndetësor në bord dhe ta dorëzojë në Autoritetet Shëndetësore të Pikës së Hyrjes.

5. Pasi avioni është ulur dhe pasagjerët e tjerë janë zbritur nga avioni, pasagjeri i izoluar dhe kur kërkohet, anëtarët e ekuipazhit do të transferohen, sipas udhëzimeve të autoriteteve lokale të shëndetit.

6. Pasagjerët e ulur gjatë së njëjtës radhë apo deri në dy radhë me larg rastit të dyshuar, si dhe kushdo që ka pasur kontakt me të gjatë udhëtimit mund të konsiderohen kontakte të afërta dhe do të intervistohen dhe do të ndiqen nga ana epidemiologjike nga autoritete publike shëndetësore të vendit hyrës.

7. Operatori ajror duhet të marrë informacion mbi rezultatin e testimit për rastin e dyshuar sa më shpejt të jetë e mundur.

8. Anëtarë i ekuipazhit që ofroi shërbimin në fluturim për rastin e dyshuar, konsiderohet kontakt i afërt dhe do të kryejë vetizolim pas kthimit në vendin e tij të origjinës, si dhe nuk do të shërbejë në rrugën e kthimit të linjës së udhëtimit ajror, duke respektuar të gjitha masat strikte të sigurisë.

9. Nëse rasti i dyshuar rezulton pozitiv, ekuipazhi përkatës do të vendoset në karantinë për 14 ditë. Nëse testi rezulton negativ, ata mund të rifillojnë detyrat në fluturim.

10. Pas largimit të rastit të dyshuar, pastrimi dhe dezinfektimi i avionit duhet të kryhet sipas instruksioneve në fuqi. MMP-të e përdorura duhet të vendosen në një qese mbetjesh e veçantë e mbyllur mirë, e cila mund të procedohet sipas udhëzuesve për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

11. Nëse një pasagjer i dyshuar identifikohet përpara ngritjes së avionit, aeroporti dhe mjeku përkatës i ISHSH-së, duhet të njoftohen nëpërmjet koordinatorit të caktuar, sipas këtij protokoll, dhe ndiqen instruksionet në fuqi. Nëse nuk ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë mes ekuipazhit dhe të dyshuarit, nuk ka nevojë të merren masa shtesë, në lidhje me menaxhimin e ekuipazhit, përveçse kur udhëzohet nga ISHSH-ja.

7. MENAXHIMI I PASAGJERËVE NË MBËRRITJE

1. Pasagjerët duhet të kujtohen nga operatori ajror mbi detyrimin për të mbajtur maskën dhe respektimin e distancës gjatë lëvizjes më këmbë.

2. Për pasagjerët në mbërritje dalja nga avioni kryhet me radhë, duke respektuar distancën. Zbritja nga avioni bëhet me rreshta, duke filluar me rreshtin në korridor, që është më pranë daljes së avionit, e duke vijuar me rreshtin që është në anën tjetër të korridorit, e më pas dalin me radhë karriget e mesit e në fund ato të dritares.

3. Lëvizja e tyre drejt pikës së kontrollit të pasaportave kryhet më këmbë. Nëse lëvizja kryhet me autobus, numri i autobusëve duhet të shtohet, me qëllim garantimin e distancës fizike përkatëse. Në pritje vendosen shenjat e ruajtjes së distancës.

4. Operatorët ajrorë do të japin për autoritetet e shëndetit publik, pa vonesë dhe pa shkelur rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat e mëposhtme:

- emrin e plotë;
- vendin e pasagjerit;
- numër telefoni ose adresë *email*.

5. Asnjë pasagjer simptomatik nuk duhet të riatdhesohet me një fluturim të rregullt pasagjerësh.

6. Pritja e bagazheve, si dhe kontrollet e mundshme doganore kryhen duke respektuar distancën e sigurisë prej 1 metrash. Nuk duhen lejuar grumbullimet e personave në daljen e bagazheve. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të mundësojë shpërndarjen e bagazheve sa më shpejt të jetë e mundur.

7. Me daljen nga zona e mbërritjeve, pasagjeri vijon me dezinfektimin e duarve përpara se të largohet nga ambientet e brendshme të aeroportit.

8. MENAXHIMI I EKIPIPAZHIT

Anëtarët e ekuipazhit, anëtarët e stafit të aeroportit dhe anëtarët e ofrimit të shërbimeve duhet të përjashtohen nga procedurat e kontrollit të COVID-19, nëse operatorët ajrorë dhe enti menaxhues i aeroportit dëshmojnë se kanë në fuqi dhe zbatojnë një procedurë ekuivalente për të monitoruar gjendjen shëndetësore të stafit të tyre.

Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të garantojë radhë të veçantë për ekuipazhin.

9. INFORMIMI

1. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19 sipas *checklist*-ës së miratuar dhe numrin jeshil për denoncim.

2. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të afishojë posterin informues mbi uljen e riskut të COVID-19, sipas formatit të miratuar dhe numrin jeshil për denoncim.

3. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të afishojë deklaratën për zbatimin e protokollit të aeroportit nga personat e punësuar/pasagjerët.

4. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të përgatisë materiale informuese ku do të përfshihet detyrimi për vetëvlerësim të simptomave nga personeli i punësuar/pasagjeri/çdo person tjetër, palë e tretë, që hyn e del në aeroport; mundësia e ndalimit të udhëtimit për pasagjerët me simptoma; detyrimin për të zbatuar rregullat e distancimit fizik, atë të mbajtjes së maskës, të etikës respiratore, higjienës etj., përgjegjësia për personin apo subjektin juridik që nuk merr masat, sipas detyrimeve ligjore dhe këtij protokollit etj.

5. Autoritet i Aviacionit Civil mbikëqyr marrjen e masave nga Enti Menaxhues i Aeroportit dhe shoqëritë ajrore, sipas detyrimeve të këtij protokollit.

6. Materialet afishohen në hyrje-dalje të aeroportit, si dhe në vende të dukshme në brendësi të tij dhe bëhen publike me mjete të tjera alternative, si: *Website*, pamje video etj.

7. Gjuha e përdorur do të jetë shqip dhe anglisht.

8. Operatorët ajrorë në momentin e blerjes së biletës i japin pasagjerit informacione mbi fluturimin dhe rregullat e sjelljes të diktuar nga emergjenca shëndetësore në proces dhe, më në veçanti, ato që kanë të bëjnë me kufizimet e udhëtimit për të gjithë pasagjerët që paraqesin simptoma të pajtueshme me COVID-19 para mbërritjes në aeroportin e nisjes. Kërkohet që Enti Menaxhues i Aeroportit dhe operatorët ajrorë të koordinohen mes tyre për të ofruar udhëzime unike për përdoruesit e tyre, në lidhje me përdorimin e saktë të aeroportit/terminalit të nisjes dhe të mbërritjes. Në kohën e riaktivizimit të operimeve në aeroport/terminal kërkohet një koordinim i fushatave ndërgjegjësuere drejtuar pasagjerëve për përdorimin e transportit ajror, në përputhshmëri të plotë me rregullat për parandalimin e përhapjes së virusit.

SHTOJCË 1

NJOFTIMI I GJENDJES SHËNDETËSORE PËRPARA LËSHIMIT TË LEJES SË KALIMIT NË BORD (*BOARDING PASS*)

Më poshtë paraqitet një format/model njoftimi për gjendjen shëndetësore që duhet plotësuar përpara lëshimit të një leje kalimi bordi, individualisht nga çdo pasagjer.

Unë e kuptoj se duhet të njoftoj _____

(emrin e transportuesit ose agjentit)

sa më shpejt të jetë e mundur dhe se në asnjë rast nuk duhet të pretendojë për fluturimin, nëse gjendet e fshehur ndonjë nga deklaratimet e mëposhtme:

- Jam diagnostikuar me COVID-19 gjatë periudhës 14-ditore para fluturimit tim.
- Kam pasur simptoma të COVID-19 (ethe; kollë rishitas; humbje të shijes ose nuhatjes, bllokim të frymëmarrjes) gjatë periudhës 8-ditore para fluturimit tim.
- Kam qenë në kontakt të ngushtë (p.sh. më pak se 2 metra për më shumë se 15 minuta) me një person që ka pasur COVID-19, në periudhën 14-ditore para fluturimit tim.

Më është kërkuar nga rregullat kombëtare ose vendore të karantinohem për arsye të lidhura me COVID-19 për një periudhë që përfshin datën e fluturimit.

Unë e kuptoj se ndonjë nga këto rrethana mund të çojnë në refuzimin e nisjes së udhëtimit tim, nëse unë nuk e deklaroj këtë informacion për transportuesin dhe rrethanat e mija zbulohen në vend në aeroport.

Emri, mbiemri

SHTOJCË 2 PROMOVIMI I SIGURISË SË SHËNDETTIT

Mesazh i përgjithshëm:

- Mbani maskat mjekësore të fytyrës, siguroni përdorimin e tyre korrekt dhe ndërrojeni çdo 4 orë (përveç kur instruksioni thotë ndryshe).
- Kujdesuni për distancimin fizik (1 metër).
- Lani duart rregullisht për së paku 20 sekonda me sapun dhe ujë ose, kur nuk është mundur, përdorni alkool për dezinfektimin e duarve.
- Mbuloni gojën dhe hundët me shami/letër për hundët ose bërrylin e përkulur kur teshtini, ose kolliteni.
- Ruani kontaktin direkt me sipërfaqet dhe njerëzit,
- Tregoni kujdes për të tjerët – si një mënyrë për t'i mbrojtur ata.

Para largimit nga aeroporti:

- Plotësoni PyetëSORIN e Monitorimit të Shëndetit të dhënë nga Transportuesi Ajror.
- Mos udhëtoni për në aeroport nëse keni thënë po për ndonjë nga pyetjet e këtij pyetëSORI.
- Jini në dijeni se vetëm pasagjerët duhet të hyjnë në terminalin e aeroportit në nisje dhe në mbërritje (të tjerë njerëz të lejuar, të cilët mund të hyjnë në terminal janë ata që shoqërojnë ose marrin një pasagjer që kërkon asistencë - Personat me Aftësi të Kufizuara Lëvizjeje ose fëmijët e pashoqëruar).
- Lexoni materialin e promovimit të sigurisë shëndetësore nga transportuesi juaj ajror.
- Kontrolloni nëse keni mjaftueshëm maska mjekësore për fytyrën dhe xhel sanitar për udhëtimin tuaj.
- Sigurohuni të keni kohë të mjaftueshme për udhëtimin, duke përfshirë dhe kontrollet në aeroport.

Në aeroport:

- Kërkoni nga personeli sqarim nëse keni ndonjë pyetje/dyshime ose ndieni vështirësi (ata janë aty t'ju ndihmojnë ju në situatën e re).
- Bëni gati PyetëSORIN e Monitorimit të Shëndetit (nëse nuk e keni elektronik, në celular).
- Vini re barrierat fizike ose shenjat që tregojnë distancën e nevojshme fizike.
- Kontrolloni bagazhin tuaj (*check in*) kur mundesh.
- Minimizoni përdorimin e fasiliteve të aeroportit.
- Parashikoni mohimin e lejitimit të hyrjes në bord, nëse nuk e keni vënë maskën.

Në avion:

- Pyesni stjuardesën nëse keni ndonjë pyetje/dyshime ose ndieni vështirësi (ata janë aty t'ju ndihmojnë ju në situatën e re) dhe tregoni mirësjellje ndaj tyre.
- Ndiqni demonstrimin e sigurisë ajrore në kabinë, për t'u njohur se çfarë mund t'i ndodhë fluturimit tuaj.
- Minimizoni përdorimin e valvulës individuale të ajrit, sa më shumë të jetë e mundur.

B. MENAXHIMI I OPERIMEVE NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE

1. TRANSPORTI QYTETËS/URBAN I UDHËTARËVE ME AUTOBUS

1. Në transportin qytetës të udhëtarëve me autobus do të lejohet udhëtimi duke respektuar distancën prej 1 m midis udhëtarëve.

2. Udhëtarët duhet të jenë të pajisur me maska, si dhe të respektojnë distancën e sigurisë prej 1 m.

3. Në stacionet e qëndrimit të respektohet masa e distancimit social prej 1 m.

4. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maskë mbrojtëse.

5. Mjetet e operimit do të dezinfektohen çdo ditë në ambientet e subjektit të licencuar.

6. Mjetet e operimit në transportin qytetës duhet të pajisen me dezinfektantë me bazë alkooli dhe me shenja sinjalizuese për qëndrimin e udhëtarëve, duke respektuar masën e distancimit social.

7. Në çdo mjet do të vendosen postera për respektimin e rregullave të higjienës të rekomanduara nga OBSH-ja, të vendosura në vende të dukshme për udhëtarët.

8. Gjatë udhëtimit duhet të bëhet i mundur ajrimi i ambienteve të brendshme të mjetit duke mbajtur dritaret hapur, përgjatë gjithë kohës së udhëtimit.

9. Subjektet e licencuara duhet të sigurojnë respektimin e masave të higjienës, distancimit social, dhe rregullat për hipjen/zbritjen e udhëtarëve.

10. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi.

2. TRANSPORTI NDËRQYTETËS I UDHËTARËVE ME AUTOBUS

1. Udhëtarët lejohen të udhëtojnë duke respektuar distancën prej 1 m midis udhëtarëve.

2. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maska dhe ka për detyrë të kontrollojë respektimin e masave në mjet.

3. Udhëtarët duhet detyrimisht të mbajnë maska përgjatë gjithë udhëtimit.

4. Hipja dhe zbritja e udhëtarëve duhet të bëhet në dyer të ndryshme të mjetit, të parashikuara për këtë qëllim.

5. Nëse udhëtari shfaq simptoma të COVID-19, bazuar në rekomandimet e MSHMS-së, ISHP-së dhe OBSH-së, drejtuesi i mjetit duhet të lajmërojë Urgjencën Kombëtare në numrin e kontaktit 127 dhe të mos lejoje hipjen ose të zbrësë udhëtarin në stacionin më të afërt, kur simptomat shfaqen gjatë udhëtimit.

6. Subjektet e transportit të licencuara, në nisje duhet të dezinfektojnë mjetin, bagazhet, si dhe të ketë dezinfektantë me bazë alkooli, për t'u përdorur nga udhëtarët në momentin e hipjes.

7. Gjatë udhëtimit duhet të bëhet ajrimi i ambienteve të brendshme të mjetit, duke mbajtur dritaret hapur, përgjatë gjithë kohës së udhëtimit.

8. Në terminale dhe stacione duhet të zbatohet masa e distancimit social prej 1 m.

9. Terminalet dhe stacionet për hipjen dhe zbritjen e udhëtarëve do të dezinfektohen çdo ditë nga Bashkia përkatëse, në bashkëpunim me Njësinë Menaxhuese të terminalit/stacionit.

10. Në çdo mjet do të vendosen postera në vende të dukshme për udhëtarët për respektimin e rregullave të higjienës, të rekomanduara nga MSHMS-ja dhe ISHP-ja.

11. Subjektet e transportit të licencuara duhet të sigurojnë respektimin e masave të higjienës, distancimit social dhe rregullat për hipjen/zbritjen e udhëtarëve.

12. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi.

3. TRANSPORTI RRETHQYTETËS I UDHËTARËVE ME AUTOBUS

1. Në transportin rrethqytetës të udhëtarëve me autobus do të lejohet udhëtimi, duke respektuar distancën prej 1 m midis udhëtarëve.

2. Udhëtarët duhet të jenë të pajisur me maska, si dhe të respektojnë masën e sigurisë prej 1 m.

3. Në stacionet e qëndrimit të respektohet masa e distancimit social prej 1 m.
4. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maskë mbrojtëse.
5. Mjetet e operimit do të dezinfektohen çdo ditë në ambientet e subjektit të licencuar. Mjetet e operimit duhet të pajisen me dezinfektantë me bazë alkooli dhe me shenja sinjalizuese për qëndrimin e udhëtarëve, duke respektuar masën e distancimit social.
6. Në çdo mjet do të vendosen postera për respektimin e rregullave të higjienës të rekomanduara nga MSHMS-ja dhe ISHP-ja, të vendosura në vende të dukshme për udhëtarët.
7. Gjatë udhëtimit duhet të bëhet e mundur ajrimi i ambienteve të brendshme të mjetit, duke mbajtur dritaret hapur, përgjatë gjithë kohës së udhëtimit.
8. Subjektet e transportit të licencuara duhet të sigurojnë respektimin e masave të higjienës, distancimit social dhe rregullat për hipjen/zbritjen e udhëtarëve.
9. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi.

4. TRANSPORTI I RREGULLT NDËRKOMBËTAR I UDHËTARËVE ME AUTOBUS ME NISJE NGA SHQIPËRIA

1. Udhëtarët lejohen të udhëtojnë duke respektuar distancën prej 1 m midis udhëtarëve.
2. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maska dhe të kontrollojë respektimin e masave në mjet.
3. Udhëtarët duhet detyrimisht të mbajnë maska përgjatë gjithë udhëtimit.
4. Hipja dhe zbritja e udhëtarëve duhet të bëhet në dyer të ndryshme të mjetit, të parashikuara për këtë qëllim.
5. Në nisje do të matet temperatura e çdo udhëtari nga subjekti transportues, duke mos lejuar personat të udhëtojnë që shfaqin temperaturë mbi 37.5 gradë. Nëse udhëtari shfaq simptomat e tjera të COVID-19, bazuar në rekomandimet e MSHMS-së dhe ISHP-së, subjekti transportues duhet të lajmërojë Urgjencën Kombëtare, në numrin e kontaktit 127.
6. Në pikat e kalimit kufitar do të ketë kontroll nga personeli mjekësor, ku çdo udhëtar do t'i nënshtrohet matjes së temperaturës dhe, nëse shfaq simptoma nuk do të lejohet të udhëtojë, duke njoftuar organet kompetente.
7. Subjektet e licencuara të transportit, në nisje duhet të dezinfektojnë mjetet, bagazhet, si dhe të kenë dezinfektantë me bazë alkooli për t'u përdorur nga udhëtarët në momentin e hipjes.
8. Mjetet duhet të kenë ajrim natyral dhe duhet të kryejnë ndalesa periodike në vende të lejuara për ndalimin e tyre në territorin shqiptar dhe në territorin e vendit destinacion, sipas stacioneve të miratuara të cituara në autorizimin përkatës për shërbimin në linjë të rregullt ndërkombëtare ose shërbimet turistike. Përgjatë ndalesave duhet të shmangët maksimalisht kontakti me personat e tjerë që nuk janë pjesë e udhëtimit.
9. Pas çdo ndalesë duhet të kryhet domosdoshmërisht dezinfektimi i duarve.
10. Terminalet/stacionet e autobusëve të transportit ndërkombëtar në linjë të rregullt duhet të dezinfektohen çdo ditë.
11. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi të vendit të origjinës dhe vendit destinacion.

5. TRANSPORTI I RREGULLT NDËRKOMBËTAR I UDHËTARËVE ME AUTOBUS ME KALIM TRANZIT NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Drejtuesi i mjetit dhe çdo udhëtar duhet të respektojë rregullat e vendosura dhe t'u nënshtrohet kontrolleve nga shteti shqiptar.
2. Në pikat kufitare hyrëse, drejtuesi i mjetit dhe çdo udhëtar do t'i nënshtrohen kontrollit nga personeli mjekësor dhe matjes së temperaturës. Nëse një person shfaq temperaturë mbi 37.5 gradë

dhe simptoma të infeksionit COVID-19, nuk do të lejohet të hyjë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maska dhe të kontrollojë respektimin e masave në mjet.

4. Udhëtarët duhet të mbajnë maska përgjatë gjithë udhëtimit.

5. Mjeti duhet të ketë ajrim natyral dhe përgjatë ndalesave duhet të shmanget maksimalisht kontakti me personat e tjerë, që nuk janë pjesë e udhëtimit.

6. Pas çdo ndalesë duhet të kryhet domosdoshmërisht dezinfektimi i duarve.

7. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi.

6. TRANSPORT I RREGULLT NDËRKOMBËTAR I UDHËTARËVE ME AUTOBUS ME DESTINACION DHE/OSE TRANZIT NË TERRITORIN SHQIPTAR

1. Drejtuesi i mjetit dhe çdo udhëtar duhet të respektojë rregullat e vendosura dhe t'u nënshtrohet kontrolleve nga shteti shqiptar.

2. Në pikat kufitare hyrëse, drejtuesi i mjetit dhe çdo udhëtar do t'i nënshtrohen kontrollit nga personeli mjekësor dhe matjes së temperaturës. Nëse një person shfaq temperaturë mbi 37.5 gradë dhe simptoma të infeksionit COVID-19, nuk do të lejohet të hyjë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në rastin kur udhëtari ka certifikatë vaksinimi apo tampon negativ, udhëtari do të lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë.

3. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maska dhe të kontrollojë respektimin e masave në mjet.

4. Udhëtarët duhet të mbajnë maska përgjatë udhëtimit.

5. Hipja dhe zbritja e udhëtarëve duhet të bëhet në dyer të ndryshme të mjetit, të parashikuara për këtë qëllim.

6. Në pikat kufitare hyrëse duhet të dezinfektohet mjeti, bagazhet, si dhe përgjatë udhëtimit të ketë dezinfektantë me bazë alkooli për t'u përdorur nga udhëtarët.

7. Mjeti duhet të ketë ajrim natyral dhe duhet të kryejë ndalesa periodike në vende të lejuara për ndalimin e tyre. Përgjatë ndalesave duhet të shmanget maksimalisht kontakti me personat e tjerë, që nuk janë pjesë e udhëtimit.

8. Pas çdo ndalesë duhet të kryhet domosdoshmërisht dezinfektimi i duarve.

9. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi.

7. TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR RRUGOR I MALLRAVE

1. Mjetet dhe kabina e drejtuesit të mjetit duhet të dezinfektohen çdo ditë.

2. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me maska dhe dezinfektantë me bazë alkooli.

3. Në pikat kufitare drejtuesi i mjetit dhe punonjësit shoqërues do t'i nënshtrohen kontrollit dhe matjes së temperaturës nga personeli mjekësor. Nëse një person i angazhuar në kryerjen e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave shfaq temperaturë mbi 37.5 gradë dhe simptoma të infeksionit COVID-19, nuk do të lejohet të hyjë në territorin shqiptar ose të dalë. Në rastin kur personi ka certifikatë vaksinimi apo tampon negativ, udhëtari do të lejohet të hyjë apo të dalë në Republikën e Shqipërisë.

4. Nuk lejohet hipja e personave të paautorizuar në mjetet që kryejnë transport ndërkombëtar mallrash.

5. Ngarkimi dhe shkarkimi i mallrave duhet të kryhet nga personi i autorizuar nga subjekti dhe drejtuesi i mjetit nuk duhet të përfshihet në këtë proces.

6. Çdo drejtues mjeti dhe punonjës i përfshirë në transport të informohet mbi rrezikun e situatës, masat e marra në nivel kombëtar dhe masat e marra nga subjekti, i cili, gjithashtu, duhet të informojë

punonjësit mbi numrat e kontaktit të autoriteteve shëndetësore dhe të nxisë komunikimin elektronik midis punonjësve.

7. Të shmanget sa më shumë përdorimi i pagesave *cash* dhe të kalohet nëpërmjet kryerjes së pagesave elektronike.

8. Drejtuesi i mjetit të eliminojë ndalesat në vendet me shumë njerëz. Përgjatë ndalesave duhet të përdoren mjete mbrojtëse, të shmanget maksimalisht kontakti me personat e tjerë që nuk janë pjesë e udhëtimit. Ushqimi rekomandohet të merret më vete dhe të konsumohet brenda në kabinën e mjetit, se sa të hahet në vendet pushimi.

9. Drejtuesi i mjetit duhet të ventilojë/ajrosë rregullisht kabinën e mjetit në pikat/vendet e pushimit.

10. Agjentët doganorë të kryejnë aktivitetin e tyre, në përputhje me rregullat e higjienës dhe të distancimit social, të lejojnë vetëm 1 person në zyrë ose maksimumi 2, të ruajnë distancën prej 1.5 m, të kryejnë dezinfektimin e dokumenteve etj.

11. Të kryhet dezinfektimi çdo 24 orë i terminaleve/vendeve të qëndrimit/parkimit të transportit rrugor të mallrave.

C. MENAXHIMI I OPERIMEVE NË PORTET E HAPURA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Protokolli ka qëllim të ndihmojë në ruajtjen dhe në mbrojtjen e shëndetit të punonjësve të terminaleve, operatorëve të portit, ekipazheve dhe pasagjerëve, si dhe për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së COVID-19 në Portet e hapura në Republikën e Shqipërisë.

1. FUSHA E VEPRIMIT

Protokolli do të zbatohet nga autoritetet portuale, operatorët portual pilotët, agjentët, stivadorët, stafin tjetër të portit, pasagjerët dhe ekipazhin gjatë kryerjes së operacioneve të pilotimit, akostim/çakostim, ngarkimit dhe shkarkimit të anijeve, transportit të pasagjerëve gjatë kohëzgjatjes së Pandemisë COVID-19.

2. KËRKESAT E PËRGJITHSHME

Marrja e masave organizative dhe rregullave të hollësishme për kontrollin e epidemisë COVID-19, kontrollin rigoroz të pasagjerëve dhe të ekipazheve, funksionimin e portit, aktiviteteve operacionale, shëndetin në punë dhe të parandalimit përhapjes së COVID-19. Shkëmbimi i informacionit, izolimi në anije-port, kontrolli i hyrjes, ventilimi dhe dezinfektimi, pajisjet e mbrojtjes personale, trajtim urgjent dhe parandalimi i rrezikut të rasteve të importuara të COVID-19.

3. MENAXHIMI I INFORMACIONIT DHE RAPORTIMI

1. Informacione në mbërritje për anijet dhe ekipazhin e tyre

Sigurimi i shkëmbimit të informacionit me agjentët e anijeve, doganat dhe administratat detare dhe institucione të tjera, dhe formulimi i planeve të punës përkatëse, bazuar në informacionin e mëposhtëm të anijeve dhe ekipazhit:

1.1 Informacione në lidhje me portet e thirrjeve, oraret e mbërritjes dhe të nisjes.

1.2 Informacione rreth ekipazhit, pasagjerëve, kushteve të tyre shëndetësore, informacioneve përfshirë ndërrimin e ekipazhit, personeli që imbarkohet dhe zbarkohet, furnizimet e anijeve dhe personeli i kontaktit.

1.3 Informacione rreth karantinës së anijeve, masave parandaluese.

1.4 Informacione në lidhje me kontaktet e afërt të ekipazhit gjatë akostimit.

1.5 Informacioni i trajtimit në lidhje me ujërat e zeza dhe ujerat e ballasteve.

4. KËRKESAT PËR AUTORITETIN PORTUAL/PORTIN

1. Pajisjet e nevojshme mbrojtëse, si: maska, shërbehen për operatorët dhe sigurohen udhëzimet e duhura për përdorimin e tyre, sipas nivelit të rrezikut dhe pozicioneve të tyre të punës.

2. Autoriteti portual/porti do të rrisë rezervën dhe furnizimin me materiale antiepidemike, siç janë sigurimi i maskave mjekësore.

3. Materialet e parandalimit të epidemisë përfshijnë vetëm, maska të zakonshme, mjekësore maska mbrojtëse të nivelit të lartë.

5. KËRKESAT PARANDALUESE PËR OPERATORËT PORTUALË

1. Kërkesat e mbrojtjes për operatorët e terminalëve

1.1 Kontrolli i vendosjes së maskave të personelit të operatorit portual me ekuipazhin e anijes.

1.2 Njoftimet dhe informacione paralajmëruese për mbrojtjen dhe parandalimin e COVID-19 do të publikohen gjatë operacioneve portuale. Nga ekuipazhi kërkohet të veshin maskë.

2. Kërkesat parandaluese për pilotët

2.1 Gjatë pilotimit, piloti duhet të mbajë maska, mënyrë korrekte gjatë gjithë procesit.

2.2 Drejtuesit e automjetit që po transferon pilotin dhe ekuipazhin e anijes pilot duhet të vendosin maska mbrojtëse.

3. Kërkesat e mbrojtjes për personelin tjetër në anije

3.1 Personeli që hipën në anije do të ketë të vendosura maska.

6. MBROJTA EPIDEMIKE

1. Kërkesat e ventilimit dhe ajrimit në mjedis

1.1 Ventilimi mjedisor do të forcohet. Sallat e pritjes, mensa, salla konferencash, zona zyrash dhe hapësira të tjera duhet të jenë të pajisura me alkool, dhe furnizime të tjera dezinfektuese dhe dritaret e tyre duhet të hapen rregullisht për ventilim, për të ruajtur qarkullimin e ajrit të brendshëm jo më pak se 3 herë në ditë dhe jo më pak se 30 minuta çdo herë.

1.2 Kondicionerët do të përdoren siç duhet. Preferohet ventilimi natyral.

1.3 Rrethinat duhet të mbahen të pastra dhe të rregullta. Mbeturinat do të pastrohen dhe transportuar në kohë.

2. Pastrimi dhe dezinfektimi

2.1 Automjetet dhe anijet për transferimin e stafit do të dezinfektohen çdo herë.

2.2 Sipërfaqet e objekteve që shpesh kontaktohen (dritaret e pritjes, butonat e ashensorit, parmakët, dorezat e dyerve etj.) do të spërkatën ose fshihen me përmbajtje dezinfektuese të klorit, klor efektiv 250 mg/L ~ 500 mg/L ose fshihen me peshqirë të lagësht dezinfektues.

2.3 Zonat e mbledhjes së personelit (të tilla si: salla e pritjes, zona e zyrës, banjoja etj.) do të pastrohen dhe dezinfektohen të paktën dy herë në ditë në interval të rregullt. Këto zona do të spërkatën me dezinfektues që përmban klor (duke përdorur dezinfektues në një raport prej jo më pak se 01:50) për të siguruar që dezinfektimi përqendrimi është 20–30 ml për metër kub ose do të fshihet me dezinfektim në një përqendrim prej jo më pak se 75% alkool për pajisjet e lidhura dhe zonat që preken nga shumë njerëz. Asnjëherë nuk do të përdoret një përzierje të dezinfektuesve që përmbajnë klor dhe dezinfektues të alkoolit.

2.4 Zonat do të mbahen relativisht të mbyllura për të arritur efektin e dezinfektimit gjatë spërkatjes me dezinfektuesit. Dritaret nuk do të hapet deri 20 minuta më vonë nga spërkatja e dezinfektuesit për të mbajtur përsëri ventilimin natyral. Këto zona mund të rifillojnë duke punuar normal pas të paktën 10 minutash.

2.5 Kontejnerët e plehrave, siç janë koshat e plehrave do të pastrohen më shpesh dhe dezinfektohen rregullisht. Këto enë mbeturinash mund të spërkatën me një dezinfektues që përmban klor që përmban 250 mg/L deri 500 mg/L, ose fshij me peshqir të lagësht të dezinfektuar.

3. Mbrojtja e higjienës

3.1 Një ose dy pika kontrolli të temperaturës së trupit pa kontakt do të vendosen në hyrjet dhe daljet. Kur kryhet kontrolli i temperaturës së trupit, personeli do të përpiqet të mbajë distancën më

shumë se 1 metër e gjysmë nga personi i kontrolluar, duke veshur rroba pune, mbrojtëse maska, doreza të disponueshme ose doreza gome dhe nëse është e mundur syze mbrojtëse.

3.2 Disa punëtorë operativë, vizitorë, personel biznesi që duhet të hyjnë në zonat e punës do të veshin maska mbrojtëse, nuk do të kenë kontaktin fizik, siç janë shtrëngimi i duarve dhe përçafimi, si dhe do të mbajnë higjienë personale.

3.3 Zona e mbledhjes së personelit do të jetë e ndarë në një distancë të arsyeshme.

3.4 Të gjithë pjesëmarrësit do të veshin maska mbrojtës në distancë më shumë se 1 metër e gjysmë. Koha e takimit duhet të kontrollohet dhe dritaret mbahen të hapura nëse koha e takimit të jetë shumë e gjatë. Vendi i takimit, mobilitet, furnizimet duhet të dezinfektohen pasi të jenë përfunduar.

3.5 Do të shmangen mbledhjet e personelit për ngrënie. Ambientet e ushqimit do të dezinfektohen çdo herë para dhe pas përdorimit. I gjithë personeli do të veshë maska mbrojtëse, duke shmangur kontaktin fizik dhe duke larë duart shpesh. Do të përdoren produkte të dezinfektimit të bazuara në alkool (siç është zgjidhja 75% e alkoolit) për duar të pastra, nëse nuk ka ujë të pastër.

3.6 Do të përdoret peshqir i lagësht për dezinfektim për të fshirë dorezat e dymve, telefonat, tastierat dhe çdo vend tjetër kontakti.

3.7 Përveç inspektimit ditor të sigurisë dhe funksionimit të mallrave të rrezikshëm, do t'u kushtohet vëmendje rreziqeve elektrostatische që mund të shkaktohen nga veshja mjeteve mbrojtëse (nëse ka). Procedurat e eliminimit statik do të kryhen kur kryen hyrje në zonat e operimit të mallrave të rrezikshme.

3.8 Terminali i pasagjerëve duhet të zbatohet parandalimin dhe kontrollin, në përputhje me protokollet mbi COVID-19, parandalimin dhe kontrollin epidemik në pasagjerë terminalet me kategori të ndryshme rreziku.

7. PLANIFIKIMI I DUHUR I URGJENCËS

1. Nëse dikush nga ekuipazhi gjenden me ethe, kollitje dhe kushte të tjera anormale shëndetësore, anijes i kërkohet të ventilojë dhe të dezinfektohet, dhe të gjithë anëtarët e ekuipazhit duhet të veshin maska mbrojtëse të nivelit të lartë, izolimi i personelit dhe masa të tjera parandaluese. Në të njëjtën kohë, autoritetet e portit/porti do të miratojnë masa të rrepta të izolimit të tyre, do të bashkëpunojnë me departamentet përkatëse për t'u marrë me hetimin dhe izolimin e kontakteve të ngushta personeli i njësive të tyre.

2. Kur një person është gjetur të vjella me simptoma të rastit të dyshuar COVID-19, të vjellat do të mbulohen dhe të dezinfektohen menjëherë me një sasi të mjaftueshme të dezinfektues (siç është dezinfektuesi që përmban klor) ose një dezinfektues efektiv i thatë peshqir me materiale absorbuese të disponueshme. Pasi të jenë hequr të vjellat, dezinfektuesit që përmbajnë klor do të përdoren për dezinfektimin e sipërfaqes së objektit.

3. Pas izolimit të personit të dyshuar të infektuar, do të dezinfektohen plotësisht dhoma e kujdesit të përkohshëm dhe zonat e tjera që mund të jenë të kontaminuara. Anijet dhe automjetet e përdorura për transferimin e personave të dyshuar të infektuar do të dezinfektohen plotësisht pasi transferimi të ketë përfunduar.

8. KËRKESAT PËR MJETET DETARE TË TRANSPORTIT TË UDHËTAREVE DHE TERMINALET E DETIKUARA PËR OPERIMIN E NJERËZVE DHE TË MJETEVE NË PORT

1. Kërkesat për mjetet detare të transportit të udhëtarëve

1.1 Pasagjerët duhet të mbajnë një distancë prej 1.5 metrash ndërmjet njëri-tjetrit gjatë hipjes, zbarkimit dhe në të gjitha zonat e anijes.

1.2 Maskat janë të detyrueshme të mbahen nga pasagjerët dhe anëtarët e ekuipazhit.

2. Masat e kontrollit terminalet e dedikuara për operimin të pasagjerëve në Port:

2.1 Maskat janë të detyrueshme të mbahen nga pasagjerët dhe operatorët.

2.2 Një broshurë e shtypur me instruksione nga organi shëndetësor publik, duke shpjeguar masat, duhet t'u jepet të gjithë pasagjerëve.

Këto masa do të ndiqen edhe për jahte private që vijnë nga jashtë pas heqjes së kufizimeve.

9. PËRGJEGJËSIA

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, si dhe shtojcave përkatëse, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Autoritetet Portuale/Drejtuesit e Porteve, Drejtoritë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin dhe degët doganore në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë.

PROTOKOLL

PËR ZBATIMIN E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E COVID-19, NË TERMINALET E PASAGJERËVE, NË PORTET DETARE, SIPAS KATEGORIVE TË NDRYSHME TË RREZIKUT

Titujt			Zonë rreziku i lartë (frekuenca të dezinfektim)	Zonë rreziku i mesëm (frekuenca të dezinfektim)	Zonë rreziku i ulët (frekuenca të dezinfektim)	Vërejte
Ventilimi Ajrosje	Terminali i pasagjerëve	Intervali i ventilimit/ ajrosjes së hapësirave publike në të gjithë terminalin	Mbani ventilim, ajrosje	Çdo dy orë	Çdo katër orë	Mënyra e natyrale përdoret për ventilim, dhe koha e ventilimit është ≥ 10 minuta çdo herë; sipas kushtet e temperaturave të ajrit, ajri i kondicioner mund të jetë fikur dhe dritaret duhet të jenë të hapura gjithë ditën për ventilim
Organizimi transportit	Terminali i pasagjerëve	Shkalla e udhëtarëve të mbledhur krahasuar me numrin maksimal të udhëtarëve të parashikuar	$\leq 50\%$	$\leq 70\%$	$\leq 90\%$	Nëse një pasagjer ka temperature të trupit mbi 37.3, ose ka simptoma të COVID-19, stafi duhet menjëherë ta transferojë pasagjerin në departamentin e shëndetësisë lokale
Dezinfektimi	Terminali i pasagjerëve	Terminali i pasagjerëve: pajisje për kontrollin e bagazheve, pajisja e <i>check in</i> -it të biletave, tualetet, sallë pritjeje, objektet dhe pajisje të arritshme, shkallët, parmacë, banakë e të tjera	Çdo një orë	Çdo dy orë	Çdo katër orë	Në rast konstatimi personi me simptoma, menjëherë dezinfektoni zonën dhe objektet e kontaktit.
		Zonat e kontaktit të pasagjerëve: hyrje të mbyllura, banakët e shitjes së biletave, terminali nga ana e detit (akostimit), pikat e kontrollit pasaportave, sallat e pritjes, tualetet, pikat e kontrollit të bagazheve zyra, zyra	Çdo dy orë	Çdo katër orë	Çdo gjashtë orë	

Titujt			Zonë rreziku i lartë (frekuenca të dezinfektim)	Zonë rreziku i mesëm (frekuenca të dezinfektim)	Zonë rreziku i ulët (frekuenca të dezinfektim)	Vërejte
		shërbimi të specializuara dhe restorante e dyqane				
Titujt			Zonë rreziku i lartë (frekuenca të dezinfektim)	Zonë rreziku i mesëm (frekuenca të dezinfektim)	Zonë rreziku i ulët (frekuenca të dezinfektim)	Vërejte
Dezinfektimi	Terminali i pasagjerëve	Zonat e kontaktit të stafit: Zyrat e personelit të operatorit portual, salla e pritjes, zyrat e doganë, polici, FSPD	Çdo dy orë	Çdo katër orë	Çdo gjashtë orë	
		Pastrimi dhe dezinfektimi i duarve në banjë	E pajisur	E pajisur	E pajisur	
Mbrojtje personale	Terminali i pasagjerëve	Shkalla e mbrojtës personale e udhëtarëve, duke mbajtur maska	100%	100%	100%	
		Shkalla e kontrollit të temperaturës së trupit të pasagjerit	100%	100%	100%	
		Shkalla e stafit të veshur maska mbrojtëse	100%	100%	100%	
		Kërkesat për kontrollin e temperaturës së trupit të stafit	Çdo katër orë	Çdo gjashtë orë	Çdo herë që merr dhe lë punën	

Titujt		Zonë rreziku i lartë (frekuenca të dezinfektim)	Zonë rreziku i mesëm (frekuenca të dezinfektim)	Zonë rreziku i ulët (frekuenca të dezinfektim)	Vërejte
		Kërkesat për zonat e vëzhgimit të përkohshëm	Të gjithë pasagjerët në terminal	Të gjithë pasagjerët në terminal	N/A
		Zonat e pirjes së duhanit (nëse ka)	Mbyllur	Mbyllur	N/A
Reklamë	Terminali i pasagjerëve	Publikimi dhe njoftimi për mbrojtjen e shëndetit përmes radios, videos, posterave etj.	Në vazhdimësi	Në vazhdimësi	Në vazhdimësi